

VËLLIMI X XII /JANAR - MARS/ 2023

# VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

BULETINI ZYRTAR

## PËRMBAJTJA

Nr. 953, Datë 19. 01. 2023.....	4
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PARAGON SEMVOX GMBH NGA SHOQËRIA CARIAD SE”.	
Nr. 954, Datë 19.01. 2023.....	7
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE GR VALE S.A.C. DHE GR BAYOVAR S.A.C. NGA SHOQËRITË STATKRAFT PERU S.A. DHE STATKRAFT PERU HOLDING S.A.C.	
Nr. 955, Datë 31. 01. 2023.....	11
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VUM, A.S. NGA SHOQËRIA ELKEM CARBON AS	
Nr. 956, Datë 31. 01. 2023.....	13
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË CARIAD ESTONIA AS & HORIZON TOGETHER HOLDING LTD.”	
Nr. 957, Datë 31. 01. 2023.....	16
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRIVE BORE ARRAY LIMITED DHE NORTH IRISH SEA ARRAY WINDFARM LIMITED NGA GRUPI COPENHAGEN INFRASTRUCTURE PARTNERS DHE STATKRAFT IRELAND LIMITED.”	
Nr. 958 , Datë 31. 01. 2023.....	19
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VODAFONE MAGYARORSZÁG TÁVKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG NGA SHOQËRIA "ANTENNA HUNGÁRIA" MAGYAR MŰSORSZÓRÓ ÉS RÁDIÓHÍRKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG.”	
Nr. 959, Datë 13. 02. 2023.....	22
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TERREAL HOLDING S.A.S NGA SHOQËRIA WIENERBERGER PARTICIPATIONS S.A.S.”.	
Nr. 960, Datë 13. 02. 2023.....	25
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË JOINT - STOCK COMMERCIAL MORTGAGE BANK “IPOTEKA – BANK” NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT.”	

Nr. 961, Datë 28. 02.2023.....	28
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”.	
Nr. 962, Datë 28 . 02. 2023.....	30
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË ASSIST DIGITAL S.P.A. NGA SHOQËRIA FREEDOM 1 S.R.L. DHE DISA PERSONA FIZIKË”	
Nr. 963, Datë 28.02.2023.....	34
"Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023".	
Nr. 964, Datë 01.03. 2023.....	35
“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot, datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi."	
Nr. 965, Datë 17.03. 2023.....	38
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRISË KHIDRAT RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA SOURYA MANTHAN RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED”.	
Nr. 966, Datë 17.03. 2023.....	41
“ PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”	
Nr. 967, Datë 24. 03. 2023.....	44
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FG SOUTH EAST EUROPE S.A. NGA SHOQËRIA FUJITSU GENERAL (EURO) GMBH”.	
Nr. 968, Datë 24. 03. 2023.....	47
"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE PEEL NRE WIND FARMS (YELL) LIMITED DHE PEEL NRE WIND FARMS (NO.1) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD"	
Nr. 969, Datë 24. 03. 2023.....	50
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”	
Nr. 970, Datë 24. 03. 2023.....	55
“Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”	

## VENDIM

Nr. 953, Datë 19. 01. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË PARAGON SEMVOX GMBH NGA SHOQËRIA CARIAD SE”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19. 01 . 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

Referuar “Marrëveshje e blerjes dhe transferimit të aksioneve për blerjen dhe transferimin e të gjitha aksioneve në paragon semvox GmbH”, palët në transaksion janë:

**Pala blerëse: CARIAD SE** është një shoqëri evropiane, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e softuerit. CARIAD SE është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft.

**Volkswagen Aktiengesellschaft** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

*Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

*Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

**Pala Shitëse: paragon GmbH & Co. KGaA**, është një ortakëri e kufizuar me aksione, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: kërkim dhe zhvillim në fushën e mikroelektronikës, prodhimin dhe shitjes së pajisjeve elektronike, pajisjeve periferike dhe montimeve përkatëse, si dhe menaxhimi i patentave, licencave dhe modeleve të përdorimit.

**Shoqëria Target: paragon semvox GmbH**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman. Paragon semvox GmbH është një ofruer, rishitës dhe licencues i zgjidhjeve dhe teknologjisë softuerike të asistentëve digjitalë të AI (inteligjencë artificiale) me aktivizim zanor, me fokus në zgjidhjet për industrinë e automjeteve. Në mënyrë më të detajuar, target zhvillon dhe integron softuerin e dialogut të ndërveprimit të bazuar në AI për automjetet, shtëpitë inteligjente, elektronikën e konsumatorit dhe argëtimin në shtëpi, kujdesin shëndetësor, logjistikën etj. Shoqëria Target paragon semvox GmbH zotërohet plotësisht nga shoqëria paragon GmbH & Co. KGaA.

Target nuk është aktiv dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

## II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë paragon GmbH & Co. KGaA dhe shoqërisë CARIAD SE, është lidhur “Marrëveshje e blerjes dhe transferimit të aksioneve për blerjen dhe transferimin e të gjitha aksioneve në paragon semvox GmbH”, më datë 29 nëntor 2022.

Bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje, shitësi synon të shesë aksionet dhe blerësi synon të blejë dhe të pranojë shitjen e këtyre aksioneve. Shitësi i kalon aksionet blerësit, i cili pranon transferimin me kusht që kalimi i këtyre aksioneve të kryhet me përmbushjen e pagesës së çmimit paraprak të blerjes në llogarinë e shitësit.

Në përfundim të transaksionit, target paragon semvox GmbH do të zotërohet plotësisht direkt nga CARIAD SE dhe indirekt nga VWAG.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE, parashikuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Vlerësimi i konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i zhvillimit dhe integritit të softuerit të dialogut të ndërveprimit të bazuar në inteligjencën artificiale (AI) me fokus në zgjidhjet për industrinë e automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

CARIAD SE është një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së automjeteve dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Paragon semvox GmbH nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 954, Datë 19.01. 2023**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE GR VALE S.A.C. DHE GR BAYOVAR S.A.C. NGA SHOQËRITË STATKRAFT PERU S.A. DHE STATKRAFT PERU HOLDING S.A.C.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.01. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullojta “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar mbi përfutimin e kontrollit të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi se shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C., synonin të blinin aksionet e shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C..

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr.928, datë 05.12.2022, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm, të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C., nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 694/6 datë 28.12.2022 “Njoftim përqendrimi në kuadër të njoftimit të përfuturit të kontrollit të Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C. mbi GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C.”, jemi njoftuar mbi nënshkrimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C.

Referuar “Marrëveshjeve për Blerjen e Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

#### **Pala blerëse:**

**Blerësi 1: Statkraft Peru S.A.**, është një shoqëri anonime, e regjistruar sipas legjislacionit të Perusë, me objekt aktiviteti: Prodhimin, transmetimin, dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në nivel kombëtar dhe në përgjithësi, përkushtimi të të gjitha aktivitetet dhe bizneset e lidhura me aktivitetet e përmendura më lart, qoftë për llogari të vet ose të palëve të treta, duke qenë në gjendje të kryejë të gjitha veprimtaritë, marrëveshjet, aktet dhe kontratat që ligjet u lejojnë shoqërive të kufizuara në veçanti, zhvillimin e projekteve Cheves, Checra dhe Viroc në lumin Huaura dhe Checra, etj.

**Blerësi 2: Statkraft Peru Holding S.A.C.**, është një shoqëri anonime e mbyllur, e regjistruar sipas legjislacionit të Perusë, me objekt aktiviteti: Angazhimin për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit, administrimit, mbështetjes, konsulencës, këshillimit dhe çdo veprimtarie tjetër të korporatës, në përgjegjësinë financiare, tregtare, sociale, ligjore, etj.

Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C. janë shoqëri të zotëruara 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i energjisë së rinovueshme në Evropë, plotësisht në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

*Devoll Hydropower SHA*, është një shoqëri aksionare, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

#### **Target:**

**1. GR Vale S.A.C.**, është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Perusë, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e energjisë, energjisë së rinovueshme, ruajtjen e energjisë elektrike dhe hidrocentralet me pompa, etj. Shoqëria GR Vale S.A.C, zotëron projektin e energjisë diellore “Lupi”,



që ndodhet në rajonin e Carumas, Moquegua.

**2. GR Bayovar S.A.C.**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Perusë, e specializuar në gjenerim, transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike. Shoqëria GR Bayovar S.A.C., zotëron projektin e energjisë me erë të quajtur “Emma”, me një kapacitet të instaluar prej 72 MV , që ndodhet në rrethin e Sechura, Rajoni i Piurës.

Shoqëritë target, nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri. Ato zotërohen 100% nga shoqëritë Grenergy Peru S.A.C dhe Grenergy Renovables S.A.

#### **Pala shitëse:**

**Shitësi 1: Grenergy Peru S.A.C.**, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Perusë.

**Shitësi 2: Grenergy Renovables S.A.** është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Spanjës.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 08.12.2022, janë lidhur 2 (dy) “Marrëveshje për Blerje të Aksioneve”, të shoqërive target GR Vale S.A.C dhe GR Bayovar S.A.C., nga palët blerëse Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.

Referuar “Marrëveshjes për Blerje e Aksioneve” të shoqërisë GR Vale S.A.C. dhe “Marrëveshjes për Blerje të Aksioneve” të shoqërisë GR Bayovar S.A.C., Shitësit janë të interesuar të transferojnë të gjitha aksionet në shitje, në këmbim të pagesës së shumës, sipas Kushteve Paraprake dhe dispozitave në marrëveshje.

Pas Datës së mbylljes dhe pas përmbushjes së Kushteve Paraprake të Marrëveshjes, Blerësit do të kenë kontroll të vetëm të shoqërive target. Pas marrjes së autorizimit nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, palët synojnë në mbylljen e shpejtë të këtij transaksioni.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar rasteve të mëparshme të autorizuar nga AK, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C., duke u bërë pjesë e shoqërive të grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nuk janë prezent dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri. Blerësit dhe shoqëritë Target janë aktivë në tregun e zhvillimit të projekteve të energjisë nga burime jo-konvecionale në Peru.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive GR Vale S.A.C. dhe GR Bayovar S.A.C. nga shoqëritë Statkraft Peru S.A. dhe Statkraft Peru Holding S.A.C.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 955, Datë 31. 01. 2023**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VUM, A.S. NGA SHOQËRIA ELKEM CARBON AS.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31. 01. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vum, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vum, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar mbi marrjen e kontrollit të shoqërisë Vum, a.s., nga shoqëria Elkem Carbon AS.

Referuar dokumentit “Marrëveshje blerje aksionesh”, në lidhje me blerjen e VUM, a.s , palët janë:

**Blerësi: Elkem Carbon AS** është një shoqëri e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë, me veprimtari të saj: furnizimin me produkte dhe shërbime me bazë karboni për industrinë e ferroaliazheve, silikonit dhe aluminit. Elkem Carbon AS është një shoqëri brenda divizionit “Zgjidhjet e Karbonit” të shoqërisë Elkem ASA, i cili zotërohet plotësisht nga kjo e fundit.

Elkem ASA është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. ELKEM ASA është një prodhues i silikonëve, lidhjeve për industrinë e shkrirjes, karbonit dhe mikrosilikateve dhe një ofrues global i zgjidhjeve të materialeve të avancuara.

Asnjë nga shoqëritë e grupit që kontrollon ELKEM ASA nuk ka filiale të themeluara në Shqipëri.

**Shitësi: Delta Consult, a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë.

**Target: Vum, a.s.**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt:

blerjen e mallrave për qëllime të rishitjes së tyre të operatorëve të tjerë tregtarë, ndërmjetësimi i biznesit në kuadër të licencës së tregtisë së lirë, mbajtja e kontabilitetit etj., Vum, a.s., është një shoqëri aktive në tregun e produkteve të karbonit.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 05 janar 2023, është nënshkruar “Marrëveshje blerje aksionesh”, në lidhje me blerjen e VUM, a.s., nga pala blerëse Elkem Carbon AS dhe pala shitëse Delta Consult, a.s.

Referuar kësaj marrëveshje, synohet blerja e 100% e aksioneve në Vum, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS, [...].

Palët synojnë të mbyllin transaksionin e propozuar sapo të përmbushen të gjitha kushtet e mbylljes dhe të merren autorizimet e nevojshme.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i produkteve të karbonit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundim i kontrollit të shoqërisë VUM, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS.

Elkem Carbon AS është një shoqëri norvegjeze, e cila zotërohet nga shoqëria Elkem ASA. Elkem ASA nuk ka filiale, degë, zyra përfaqësimi apo aktivitet në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri gjatë vitit 2021.

VUM, a.s. është një shoqëri sllovaqe, aktive në tregun e produkteve të karbonit. VUM, a.s. aktualisht është 100% në pronësi të shoqërisë DELTA Consult, a.s. VUM, a.s. nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Vum, a.s. nga shoqëria Elkem Carbon AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 956, Datë 31. 01. 2023**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË CARIAD ESTONIA AS & HORIZON TOGETHER HOLDING LTD.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31. 01. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë CARIAD Estonia AS & Horizon Together Holding Ltd.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë CARIAD Estonia AS & Horizon Together Holding Ltd.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë CARIAD Estonia AS & Horizon Together Holding Ltd.

Referuar dokumentit “Marrëveshje sipërmarrje e përbashkët”, palët janë:

**Pala 1: CARIAD Estonia AS** është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Estonisë. CARIAD Estonia AS është një nga qendrat ndërkombëtare për kompaninë e softuerit të automobilave CARIAD të Grupit Volkswagen. CARIAD Estonia AS është një filial i zotëruar plotësisht nga CARIAD SE.

CARIAD SE, është një shoqëri evropiane, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe

pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e softuerit. CARIAD SE është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft.

Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: Prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve:

*Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

*Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

**Pala 2: Horizon Together Holding Ltd.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Ishujve Kaiman. Horizon Together Holding Ltd. është një filial në pronësi të plotë të Horizon Robotics.

Horizon Robotics është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Ishujve Kaiman. Horizon Robotics është një ofrues i zgjidhjeve kompjuterike me efikasitet energjetik për sistemet e avancuara të ndihmës së shoferit (ADAS) dhe drejtimin autonom (AD) për automjetet inteligjente. Horizon Robotics tregton produktet e integruara ADAS dhe AD të automjeteve të pasagjerëve në Kinë dhe është e përkushtuar të përmirësojë përvojat inteligjente të drejtimit të gjeneratës së ardhshme të automjeteve, duke integruar harduerin dhe softuerin, duke përfshirë zgjidhjet kompjuterike të harduerit me fuqi të ulët dhe mjetet e zhvillimit të softuerit të hapur.

Horizon nuk është aktiv dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

**Ndërmarrja e Përbashkët (JV)**, do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të themelohet në Republikën Popullore të Kinës. JV do të themelohet në Republikën Popullore të Kinës dhe do të angazhohet në sektorin inteligjent të drejtimit të makinave. Në mënyrë të veçantë, JV do të furnizojë veçmas çipa inteligjente të drejtimit dhe softuer inteligjent të drejtimit për prodhuesit e automjeteve (OEM). Klientët kryesorë të JV do të jenë sipërmarrjet e përbashkëta OEM të Grupit VW në Kinë.

Fokusi kryesor i JV, ku do të ushtrojë aktivitetin, do të jetë Republika Popullore e Kinës.

## II. Përqendrimi

Më datë 17 nëntor 2022 është nënshkruar “Marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët” nga shoqëritë CARIAD Estonia AS dhe Horizon Together Holding Ltd.

Referuar kësaj marrëveshjeje, CARIAD Estonia AS zotëron interesa kapitali në shoqëri, që përbëjnë 60% të kapitalit total të regjistruar të shoqërisë dhe Horizon Together Holding Ltd. zotëron interesa kapitali në shoqëri, që përbëjnë 40% të kapitalit total të regjistruar të shoqërisë.

Vendimet si, shqyrtimi dhe miratimi i Planeve të Buxhetit Vjetor; shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të Bordit të Drejtorëve; shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të Mbikëqyrësve, etj, të marra nga Asambleja e Ortakëve do të miratohen nga ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% të të drejtave totale të votës.

Referuar marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët dhe mënyrës së vendimmarrjes, konstatohet se ndërmarrja e re (JV) do të kontrollohet nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Bazuar në marrëveshjen e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (JV), si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10

dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e Konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të çipave dhe softuerëve inteligjent të drejtimit të automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

CARIAD Estonia AS zotërohet nga CARIAD SE, një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen,. Grupi VW operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së automjeteve dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Horizon Together Holding Ltd. nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

JV do të themelohet në Republikën Popullore të Kinës dhe do të angazhohet në sektorin inteligjent të drejtimit të makinave. Në mënyrë të veçantë, JV do të furnizojë veçmas çipa inteligjente të drejtimit dhe softuer inteligjent të drejtimit për prodhuesit e automjeteve (OEM). Klientët kryesorë të JV do të jenë sipërmarrjet e përbashkëta OEM të Grupit VW në Kinë.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë CARIAD Estonia AS dhe Horizon Together Holding Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 957, Datë 31. 01. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRIVE BORE ARRAY LIMITED DHE NORTH IRISH SEA ARRAY WINDFARM LIMITED NGA GRUPI COPENHAGEN INFRASTRUCTURE PARTNERS DHE STATKRAFT IRELAND LIMITED.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31. 01. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Partners dhe Statkraft Ireland Limited.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Partners dhe Statkraft Ireland Limited.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi se shoqëritë CI IV Irish Sea Holdco I Limited dhe CI IV Irish Holdco II Limited, synonin të blinin aksionet e shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited.

Referuar “Marrëveshjeve për Blerjen e Aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

#### Shoqëritë blerëse

**CI IV Irish Sea Holdco I Limited dhe CI IV Irish Holdco II Limited** janë shoqëri private të kufizuara nga kuotat, të themeluara në Irlandë.

Shoqëritë CI IV Irish Sea Holdco I Limited dhe CI IV Irish Holdco II Limited janë shoqëri holding, të cilat synojnë të bëhen aktive në investime në projekte të gjenerimit të energjisë nga era në det të hapur (offshore). Këto entitete janë themeluar rishtazi dhe si të tilla nuk kanë aktivitete të mëparshme në asnjë fushë.



Shoqëritë e mësipërme janë pjesë e grupit Copenhagen Infrastructure Partners, një shoqëri administrimi e fondeve të investimit e specializuar në investimet në infrastrukturën energjetike. Grupi Copenhagen Infrastructure Partners është aktiv në projekte në një gamë të gjerë teknologjish, përfshirë energjinë nga era në det të hapur (offshore), energjinë nga era në tokë (onshore), energjinë diellore, biomasa dhe energjinë nga mbetjet, transmetimin dhe shpërndarjen, kapacitete ruajtje dhe magazinimi, dhe asete të tjera të energjisë.

Grupi Copenhagen Infrastructure Partners nuk është i pranishëm me filiale dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

### **Shoqëritë Target:**

**1. Bore Array Limited** është një shoqëri private e kufizuar nga kuotat, e themeluar në Irlandë. Bore Array Limited është një shoqëri projekti, filial i Statkraft e cila po kryen fizibilitetin e zhvillimit të Fermës së Erës në det të hapur (offshore) të Bore Array në bregun e Co. Wexford në Irlandë.

**2. North Irish Sea Array Windfarm Limited** është një shoqëri private e kufizuar nga kuotat, e themeluar në Irlandë. North Irish Sea Array Windfarm Limited është një projekt i gjenerimit të energjisë nga era në det të hapur (offshore) i propozuar në bregun e qyteteve Dublin, Meath dhe Louth në Irlandë, e cila do të sjellë një mundësi për të kontribuar në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin e një të ardhme me energji të pastër, të rinovueshme në këtë rajon.

Shoqëritë target Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited zotërohen 100% nga Statkraft Ireland Limited. Shoqëritë target nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

### **Pala shitëse:**

**Statkraft Ireland Limited** është një shoqëri e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës.

Statkraft Ireland Limited është shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë. Statkraft AS është një kompani hidroenergjetike, plotësisht në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

*Devoll Hydropower SHA* është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 14 janar 2023, ndërmjet shoqërive Statkraft Ireland Limited; CI IV Irish Sea Holdco I Limited dhe CI IV Irish Holdco II Limited është lidhur “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”.

Referuar kësaj marrëveshjeje, shitësi do të shesë titullin ligjor dhe përfitues të aksioneve të shitjes. Blerësi 1, *CI IV Irish Sea Holdco I Limited*, do të blejë titullin ligjor dhe përfitues të aksioneve të North Irish Sea Array Windfarm Limited dhe blerësi 2, *CI IV Irish Holdco II Limited*, do të blejë titullin ligjor dhe përfitues të aksioneve të Bore Array Limited.

Në përfundim të transaksionit, Grupi Copenhagen Infrastructure Partners dhe Statkraft Ireland Limited do të kontrollojnë bashkërisht shoqëritë target Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të 50% të aksioneve të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Infrastructure Partners.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e Konkurrencës**

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë së rinovueshme nga era në det të hapur (offshore), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Infrastructure Partners dhe Statkraft Ireland Limited.

Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited janë të angazhuara në zhvillimin e projekteve për prodhimin e energjisë nga fermat e erës në det të hapur (offshore) në Irlandë.

Grupi Copenhagen Infrastructure Partners nuk është prezent dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërive Bore Array Limited dhe North Irish Sea Array Windfarm Limited nga Grupi Copenhagen Infrastructure Partners dhe Statkraft Ireland Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 958 , Datë 31. 01. 2023**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË VODAFONE MAGYARORSZÁG TÁVKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG NGA SHOQËRIA "ANTENNA HUNGÁRIA" MAGYAR MŰSORSZÓRÓ ÉS RÁDIÓHÍRKÖZLÉSI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31. 01. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarországi Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarországi Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarországi Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje” lidhur më datë 08 janar 2023, palët janë:

**Pala blerëse:**

**-"ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, e cila e ushtron aktivitetin e saj, në fushën e ofrimit të shërbimeve të aktivitetit të programimit dhe transmetimit televiziv, transmetimit radiofonik, aktivitetet e telekomunikacionit me kablo dhe pa tela, satelitor dhe aktivitete të tjera të telekomunikacionit në Hungari.

**-4iG Nyilvánosan Működő Részvénytársaság**, (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësi periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësi periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

4iG Nyrt ka hyrë në tregun e telekomunikacionit në Shqipëri nëpërmjet marrëveshjeve të përfuturit të kontrollit të 80.27% të kuotave të shoqërisë Albtelecom SHA dhe përfuturit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD dhe indirekt të shoqërisë One Telecommunications SHA.

Shoqëritë Albtelecom SHA dhe One Telecommunications SHA, përfunduan procesin e ristrukturimit brenda grupit nëpërmjet përthithjes së shoqërisë Albtelecom SHA nga shoqëria One Telecommunications SHA dhe shoqëria e përfutur është quajtur One Albania SHA,

One Albania SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse. Komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio. Komunikim bazë në rrjetin ndër-qytetas që lidhen me transmetimin radio. d) Komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale. Komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teletekst dhe videotekst. Detar, ajror, hapësinor dhe radio-komunikim satelitor etj.

**-Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit hungarez, e cila zotërohet 100% nga shteti hungarez.

**Pala shitëse: Vodafone Europe B.V.**, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit hollandez. Vodafone Europe B.V është një kompani holding, e cila operon në sektorin e telekomunikacionit celular.

Shoqëria Vodafone Europe B.V. zotëron kontroll të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë Vodafone Albania SHA në Shqipëri, shoqëri e cila është aktive në tregun e komunikimeve elektronike.

**Shoqëria Target: Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë me aksionar të vetëm shoqërinë Vodafone Europe B.V., e cila ka si veprimtari kryesore të saj; Komunikimet pa tela, shoqëruar me veprimtari të tjera si: Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit, Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme në pronësi private, Veprimtari kontabiliteti, auditimi dhe ekspertimi tatimor, Marrja me qira e pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterin) Dhënia me qira e makinerive të tjera dhe asetëve të prekshme, Prodhimi i komponentëve elektronikë, etj.

Shoqëria Target nuk realizon xhiro në Shqipëri.

## **II. Përqendrimi**

Ndërmjet shoqërisë Vodafone Europe B.V. dhe shoqërisë "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe 4iG Nyilvánosan Működő Részvénytársaság, është lidhur "Marrëveshje shitblerje", më datë 08 janar 2023.

Shitblerja do të kryhet për të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të shoqërisë target sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Titulli i aksioneve, duke përfshirë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e bashkëngjitura aksioneve, do t'i kalojë blerësve pas përfundimit, me kusht që të gjitha palët të kenë mbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në marrëveshje.

Pas përmbylljes së Transaksionit, "ANTENNA HUNGÁRIA" Zrt. do të zotërojë 51% të kapitalit të shoqërisë target, duke përfutur kontroll të shoqërisë Target, bazuar në të drejtat e votës që i jep zotërimi i 51% të aksioneve në kapitalin themeltar të Target, ndërsa 49% të aksioneve do të zotërohet nga shoqëria hungareze Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság, e cila zotërohet 100% nga shteti hungarez.

Transaksioni është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Vlerësimi i konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i komunikimeve elektronike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

"ANTENNA HUNGÁRIA" Zrt. operon në Shqipëri përmes shoqërisë të zotëruar indirekt prej saj One Albania SHA. One Albania SHA është një shoqëri shqiptare me aktivitet në tregun e komunikimeve elektronike.

Vodafone Magyarország Távközlési Zrt. nuk ka veprimtari dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përfundimi i kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság, nuk do të sjellë ndryshim të kontrollit të shoqërisë Vodafone Albania SHA dhe përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 959, Datë 13. 02. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TERREAL HOLDING S.A.S NGA SHOQËRIA WIENERBERGER PARTICIPATIONS S.A.S.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 02. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni për blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger AG, nëpërmjet një filiali në pronësi të plotë të tij, Wienerberger Participations S.A.S.

Referuar dokumentit: Letër-Përgjigje, nga shoqëria Wienerberger AG, me subjekt: “Marrëveshje e së Drejtës së Shitjes për blerjen e grupit Terreal”, palët janë:

**Blerësi : Wienerberger Participations S.A.S.**, është një shoqëri aksionare tregtare, e regjistruar sipas dispozitave të Kodit Tregtar Francez, me objekt aktiviteti: Investim i kapitalit në të gjitha shoqëritë industriale, tregtare dhe të gjitha shoqëritë e tjera, në përgjithësi të gjitha operacionet e çdo natyre, etj.

Wienerberger Participations S.A.S., zotërohet plotësisht nga shoqëria Wienerberger AG.

**Wienerberger AG**, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Vjenës, me veprimtari të saj: ushtrim i funksionit të një shoqërie aksionare në lidhje me shoqëritë e kombinuara nën drejtimin

e tyre uniform për të formuar një grup sipas kuptimit të nenit 15 të Aktit të Korporatës Gjermane të Aksioneve. Qëllimi i korporatës së këtyre shoqërive të grupit përfshin veçanërisht prodhimin, blerjen dhe shitjen e materialeve të ndërtimit të të gjitha llojeve, ushtrimin e tregtisë së ndërtimit dhe funksionimin e pikave të karburantit.

Wienerberger AG, është pjesë e Wienerberger Group, me seli në Vjenë, i cili është një furnizues botëror i materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës, me fokus në materialet e ndërtimit të mureve, materialeve të çatisë dhe sistemit të tubacioneve.

Wienerberger Group nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon shitje të materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës.

**Shitësit:** shoqëritë ELQ Investors II Limited; Park Square Capital Parallel Partners II, LP; Park Square Capital Partners II, LP; Park Square Capital partners II Supplemental Fund, LP; PSCP III Holdings, LP; BCGSS 2 Guernsey Ltd; BCGSS 2 Sarl; Barings Global Special Situations Credit 3 S.a.r.l; Barings Global High Yield Credit Strategies Limited; Crown Managed Accounts SPC; Massachusetts Mutual Life Insurance Company; C.M. Life Insurance Company dhe OGT Invest.

**Target: Terreal Holding S.A.S.**, është një shoqëri aksionare tregtare, e regjistruar sipas legjislacionit Francez, me objekt aktiviteti: Kryerjen e të gjitha operacioneve, për llogari të tij, të blerjes, shitjes dhe menaxhimit të titujve të transferueshëm francez dhe të huaj të çdo natyre dhe të gjitha shoqërive, blerjen, abonimin, menaxhimin, shitjen, shkëmbimin e këtyre titujve, të gjitha shërbimet administrative, financiare, të kontabilitetit, tregtare, IT, menaxheriale ose të tjera në dobi të filialeve të shoqërisë ose të çdo shoqërie në të cilën ajo ka aksione, etj.

Terreal Holding S.A.S. nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

## II. Përqendrimi

Referuar Letër-përgjigjes së hartuar më datë 20 dhjetor 2022, nga shoqëria Wienerberger AG, me subjekt: “Marrëveshjen e së Drejtës së Shitjes për blerjen e grupit Terreal”, parashtrohet angazhimi i parevokueshëm i blerësit për të blerë të gjithë titujt sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në formularin e marrëveshjes së shitjes dhe blerjes, bashkangjitur kësaj marrëveshje si SPA.

Përpara se shitësit të mund të marrin vendime lidhur me një shitje të Grupit, këshilli i punës i shoqërisë Terreal SAS, duhet të informohet dhe konsultohet lidhur me transaksionin e parashikuar.

Shitja e shoqërisë target do të ndahet në dy transaksione (i) blerja nga blerësi e të gjitha aksioneve të shoqërisë target (transaksioni kryesor) dhe (ii) blerja nga (disa) shitës ose nga një palë e tretë e pavarur, e filialeve të shoqërisë target, Creaton Poloska sp. Zoo, Poloni dhe Creaton South East Europe Kft, Hungari si dhe Organizatën Austriake të Shitjeve (transaksioni dytësor).

Pas transaksionit kryesor, Wienerberger AG do të ushtrojë kontroll indirekt mbi shoqërinë target dhe filialeve të shoqërisë target nëpërmjet filialit të tij shoqërinë Wienerberger Participations S.A.S.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## III. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu prodhimit të materialeve të ndërtimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S. nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S, e cila zotërohet plotësisht nga shoqëria Wenerberger AG dhe së bashku janë pjesë e Wienerberger Group. Wienerberger Group nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon shitje të materialeve të ndërtimit dhe zgjidhjeve të infrastrukturës.

Terreal Holding S.A.S. nuk ka filial të regjistruar dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Terreal Holding S.A.S nga shoqëria Wienerberger Participations S.A.S.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



## VENDIM

Nr. 960, Datë 13. 02. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË JOINT - STOCK COMMERCIAL MORTGAGE BANK “IPOTEKA – BANK” NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13. 02. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi lidhur me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje aksionesh”, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse:** OTP Bank Nyrt, është një shoqëri aksionare publike. Objektivi themelor i shoqërisë është: të operojë si një institucion financiar i regjistruar në Hungari, duke vepruar si një institucion krediti (banke), i autorizuar të ofrojë gamën e plotë të shërbimeve bankare dhe investimeve dhe me aktivitet kryesor të shoqërisë ndërmjetësime të tjera monetare etj.

OTP Bank Nyrt, është aktive në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të saj Banka OTP Albania SHA, shoqëri me objekt aktiviteti: a) pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë, inter alia, kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe

financim të transaksioneve tregtare, etj.

**Pala shitëse:** Ministria e Financës e Republikës së Uzbekistanit, me seli në Tashkent, Republika e Uzbekistanit.

**Shoqëria Target:** Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” (“IPOTEKA - BANK”) është një shoqëri tregtare, aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Uzbekistanit, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve bankare.

## **II. Transaksioni**

Ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Uzbekistanit (shitësi) dhe shoqërisë OTP Bank Nyrt (blerësi), është lidhur “Marrëveshje shit-blerje aksionesh”, të nënshkruar më datë 12 dhjetor 2022.

Referuar kësaj Marrëveshjeje, ky transaksion do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën e parë blerësi do të blejë nga shitësi 73.71% të aksioneve të shoqërisë target IPOTEKA - BANK dhe në fazën e dytë, e cila pritet të ndodhë brenda 3 viteve, blerësi do të blejë pjesën e mbetur të aksioneve.

Në përfundim të transaksionit, OTP Bank Nyrt do të përfitojë kontrollin e plotë mbi targetin IPOTEKA - BANK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **III. Analiza e Konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar synon përfitim të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA – BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

OTP Bank Nyrt është një shoqëri aksionare publike, pjesë e Grupit OTP, e cila është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SHA në tregun e shërbimeve bankare.

IPOTEKA - BANK operon në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare, por nuk vepron dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyr.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 961, Datë 28.02.2023

### “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.02.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të qumështit”,

#### VËREN SE:

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të qumështit, nisur nga rritja e ndjeshmërisë së konsumatorëve dhe indiciet e publikuara nga media, në të cilat evidentohet rritja e fortë (rreth 37%) dhe e menjëhershme e çmimit të shitjes së nënprodukteve të qumështit, kryesisht djathë dhe gjalpë.
2. Nga monitorimi i tregut rezultoi se, gjatë gjysmës së parë të muajit shkurt, çmimet e nënprodukteve të qumështit, kryesisht djathit të bardhë, djathit kackavall dhe gjalpë, janë rritur deri në 38% nga disa prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, rritje e cila ka ndodhur në një periudhë të përafërt kohore.
3. Për sa më sipër, rritja e fortë dhe e njëkohëshme e çmimit të nënprodukteve të qumështit (kryesisht djathë e gjalpë) mund të jenë shenja të caktimit të çmimeve si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2022 deri në 31 Mars 2023.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 962, Datë 28 . 02. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË ASSIST DIGITAL S.P.A. NGA SHOQËRIA FREEDOM 1 S.R.L. DHE DISA PERSONA FIZIKË”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28 . 02 . 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë,

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë.

1. Referuar dokumentit “Marrëveshje e shitjes dhe blerjes së aksioneve” nënshkruar më datë 24 dhjetor 2022, palët në transaksion janë:

**Blerësi: Freedom 1 S.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian, filial i fondit të investimeve Ardian Expansion V Fund SLP. Freedom 1 S.r.l. është një Subjekt për Qëllime të Veçanta, i themeluar posaçërisht për këtë transaksion. Ardian Expansion V Fund SLP është një fond i specializuar profesional francez, i themeluar në formën e një shoqërie komandite, i menaxhuar nga Ardian France S.A., një shoqëri private e themeluar sipas legjislacionit francez me objekt aktiviteti: administrimi kolektiv dhe administrimi i portofolit në dobi të të tjerëve, bazuar në një program

aktiviteti të miratuar nga autoriteti francez i tregjeve financiare; ofrimi i shërbimeve të këshillimit për investime dhe komercializëm të fondeve investuese bazuar në një program aktiviteti të miratuar nga autoriteti francez i tregjeve financiare etj. Grupi Ardian është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes filialeve të kompanive të zotëruara prej tij si:

- F2A Tirana Branch, dega shqiptare e F2A S.R.L, me objekt aktiviteti: Konsulencë dhe ndihmë në fushën ekonomike dhe të së drejtës së punës në sipërmarrje dhe shoqëri, fiskale, tatimore e ligjore, kontabël, administrative dhe menaxhuese, përfshirë këtu mbajtjen e kontabilitetit të përgjithshëm dhe TVSH-së së të gjitha detyrimeve administrative dhe të kontrollit përkatës duke iu referuar strukturimit të planit të llogarive, mbajtjes së kontabilitetit analitik dhe menaxhues, përpilimit të raporteve kontabël; veprimtaritë e menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore etj.
- ASAF Tirana Branch, dega shqiptare e ANTEX SERVIZI DI ASSISTENZA FISCALE SRL, me objekt aktiviteti: Ekzekutimi i aktivitetit të asistencës fiskale.

#### **Pala shitëse:**

**Shoqëria** Wide Open S.r.l është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, aksionare e shoqërisë target Asssit Digital S.p.A. (Wide Open).

**Persona fizikë:** Z. Enrico Donati, Zj. Francesca Gabrielli, Z. Franco Fradiani, Z. Manlio Costantini, persona fizik, shtetas të huaj, aksionarë të shoqërisë target Asssit Digital S.p.A.

**Shoqëria** Dreamers Società Semplice, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian, aksionare e shoqërisë target Asssit Digital S.p.A. (Dreamers SS).

Shitës të tjerë kanë aksione në shoqërinë target Asssit Digital S.p.A.

**Target: Asssit Digital S.p.A.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, aktiv në ofrimin e Shërbimeve të Menaxhimit të Klientit (CMS). Shoqëria ofron shërbime IT, shërbime software, shërbime marketingu dhe komunikimi, aktivitete call-center në Itali, Kroaci, Shqipëri dhe Tunizi.

Asssit Digital S.p.A. është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes filialit të tij, Asssit SHPK, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Studimi, konsulenca, projektimi, realizimi dhe shërbimet e menaxhimit për kompani, ndërmarrje dhe ente drejtuese për të mbështetur shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve të vetë klientit; ofrimi i shërbimeve përmes një strukture informatike dhe telekomunikacioni të përshtatshëm (“call-center”, “help-desk”, “data-center”) për të mbështetur bizneset dhe ndërmarrjet në proceset e kontaktit me klientët e tyre; shërbime këshillimi në fushën e marketingut; përzgjedhje dhe trajnim personeli etj.

2. Referuar dokumentit “Marrëveshje e investimit dhe marrëveshja e aksionarëve” nënshkruar më datë 24 dhjetor 2022, palët në këtë marrëveshje janë:

- **Shoqëria Freedom 1 S.r.l.** (ortaku i shumicës).
- **Personat fizikë;** Z. Enrico Donati, Zj. Francesca Gabrielli, Z. Franco Fradiani, Z. Manlio Costantini, (Drejtuesit Kryesorë dhe investitorë në këtë kontratë).
- **Shoqëria Dreamers Società Semplice,** (Dreamers SS).
- **Aksionarët Operativë Investitorë,** janë 16 persona fizikë, shtetas të huaj dhe 2 shoqëri, të cilët në total zotërojnë aksione të shoqërisë target Asssit Digital S.p.A.
- **Aksionarët Jo-Operativë Investitorë,** janë 9 persona fizikë, shtetas të huaj dhe 1 shoqëri, të cilët zotërojnë aksione të shoqërisë target Asssit Digital S.p.A.

Të gjitha palët do të jenë aksionarë të shoqërisë target Asssit Digital S.p.A.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 24 dhjetor 2022, shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe shoqëria Wide Open S.r.l., Z. Enrico Donati, Zj. Francesca Gabrielli, Z. Franco Fradiani, Z. Manlio Costantini, shoqëria Dreamers Società Semplice kanë lidhur “Marrëveshjen e shitjes dhe blerjes së aksioneve”. Në po këtë datë, shoqëritë Freedom 1 S.r.l., Z. Enrico Donati, Zj. Francesca Gabrielli, Z. Franco Fradiani, Z. Manlio Costantini, shoqëria Dreamers Società Semplice, Ortakët Operativë Investitorë dhe Ortakët Jo-Operativë Investitorë kanë lidhur edhe “Marrëveshjen e investimit dhe marrëveshja e aksionarëve”.

Referuar “Marrëveshjes së shitjes dhe blerjes së aksioneve”, Freedom 1 S.r.l. do të marrë kontrollin, në mënyrë indirekte të shoqërisë target Assisist Digital S.p.A. Freedom 1 S.r.l. (TopCo) do të krijojë një shoqëri të re aksionare të emërtuar Freedom Digital S.p.A. (HoldCo). HoldCo do të themelojë një shoqëri tjetër, MidCo dhe kjo e fundit do të krijojë një shoqëri tjetër, BidCo, për transaksionin e blerjes së Target.

Bazuar në “Marrëveshjen e Investimit”, Drejtuesit Kryesorë do të riinvestojnë në HoldCo një pjesë të të ardhurave që do të marrin nga shitja e aksioneve të tyre në target. Referuar Marrëveshjes së Investimit, edhe pse Drejtuesit Kryesorë do të zotërojnë përqindje të vogla të pronësisë së kapitalit aksionar të HoldCo, ata do të ushtrojnë një kontroll të rëndësishëm në Target, HoldCo, MergeCo dhe MidCo përmes emërimit të anëtarëve në Këshillin e tyre të Administratorëve, nëpërmjet votave të nevojshme për miratimin e vendimeve të caktuara dhe përmes ndikimit të tyre të rëndësishme në miratimin e disa çështjeve të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të HoldCo.

Referuar marrëveshjeve, transaksioni i njoftuar përbën një përfitim kontrolli mbi të drejtën e vetos.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assisist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë, parashikuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **III. Vlerësimi i konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve të menaxhimit të klientit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar do të sjellë përfitim të kontrollit të përbashkët i shoqërisë Assisist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë.

Freedom 1 S.r.l. është një filial i fondit të investimeve Ardian Expansion V Fund SLP, pjesë e Grupit Ardian, i cili është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes disa filialeve të kompanive të zotëruara prej tij, me objekt aktiviteti ekzekutimi i aktivitetit të asistencës fiskale.

Assisist Digital S.p.A. është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes filialit të tij, Assisist SHPK, me objekt aktiviteti ofrimi i Shërbimeve të Menaxhimit të Klientit (CMS).

Freedom dhe Ardian nuk janë aktivë në Shqipëri në sektorin ku operon Target.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

**PËR KËTO ARSYE:**



Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 963, Datë 28.02.2023

**"Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023".**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28. 02. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** "Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023".

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (c) të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023,

### VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (c) të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, ka depozituar Draft Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (c) të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar;

### VENDOSI:

- I. Miratimin e "Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022 dhe prioritetet kryesore për vitin 2023", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIM**

**Nr. 964, Datë 01.03. 2023**

**“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot, datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.03. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Marrja e masës së përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të autoshkollave (Shoqata "Kombëtare e Autoshkollave dhe Shoqata e Autoshkollave "Siguria në rrugë"), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 44, neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., date 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 3532/1 prot.. date 23.02.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

**VËREN SE :**

1. Autoriteti i Konkurrencës, nisur nga njoftimi i bere në median e shkruar me datë 21 shkurt 2023. për një marrëveshje ndërmjet Grupeve të interesit përfaqësues të autoshkollave (Shoqata "Kombetare e Autoshkollave dhe Shoqata e Autoshkollave Seguria në rruge). Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme te Shërbimeve të Transportit Rrugor, në lidhje me përcaktimin e kostos minimale fiskale (tarifat e pagesës) së përgatitjes për drejtues injeti, bazuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 "Per mbrojtjen e konkurrencës", ka filluar procedurat e vlerësimit të kësaj marrëveshje. Në kuadër të këtij vlerësimi, me anë të shkresës nr. 147 prot., date 22.02.2023, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. Me shkresën nr. 3532/1 prot., datë 23.02.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (protokolluar pranë AK me nr. 147/1 prot, date 24.02.2023) pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshtokollave. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
3. Referuar nenit 1, pika 1.1, të Akt Marrëveshjes, objekti i kësaj Marrëveshje është njohja ndërmjet palëve me tarifën e pagesës, si dhe vlerësimin e kostos minimale fiskale referuese, për përmbushjen e programit të edukimit për përgatitjen për drejtues mjete dhe pajisjen me kategoritë e lejedrejtimit: AM, A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C CIE, CE, DI, D, DIE, DE, për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj, si dhe përgatitjen për pajisjen me dëshmitë dhe certifikatat të aftësisimit profesional.
4. Në nenin 2 të Akt Marrëveshjes përcaktohet tarifa e pagesës dhe kosto referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose certifikatës. Në pikën 2.1 të këtij neni përcaktohet se, në tarifën e pagesës për përgatitjen dhe fitimin e kategorisë së leje drejtimit, dëshmisë ose certifikatës përfshihen: kosto minimale fiskale, TVSH, fitimi dhe vlera 80% e kostove administrative (KA) të pajisjes me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 331 të VKM nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Analiza e kostos minimale fiskale në përlllogaritjen e kësaj tarife është vlerë referuese për efekt fiskal, mbi gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetin "Autoshtokollë" në RSH sipas tabelës bashkëlidhur marrëveshjes.
5. Neni 4 i ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", ndalon të gjitha marrëveshjet të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që caktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi. Në kuptim të këtij neni, Akt Marrëveshja nr. 2729 prot, date 13.02.2023, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshtokollave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila përcakton tarifën e pagesës dhe koston referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, mund të ketë elemente të kufizimit të konkurrencës.
6. Në respektim të nenit 44 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se jemi përpara një rasti urgjence, pasi Akt Marrëveshja për përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nëpërmjet përcaktimit të tarifës minimale ka rrezik të sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në ofrimin e këtyre shërbimeve, duke reduktuar seriozisht përfitimet që tregjet konkurruese ofrojnë për konsumatorët.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 44, nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës"

#### **VENDOSI:**

- I.** Marrjen e masave të përkohshme ndaj palëve nënshkruese të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës Kombëtare të Autoshkollave", Shoqatës së Autoshkollave "Siguria në rrugë" dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si vijon:
- 1.** Ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me percaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi,
- II.** Depozitimin pranë AK-së të të gjithë praktikës së ndjekur deri në nënshkrimin e kësaj Akt Marrëveshjeje, për të kryer vlerësimin ligjor të saj, bazuar në nenin 4, nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës": Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës administrative dhe marrjen e vendimit përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës.
- III.** Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, germa b), të Ligjit nr. 9121/2003.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 965, Datë 17.03. 2023

### “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË KUOTAVE TË SHOQËRISË KHIDRAT RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA SOURYA MANTHAN RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.03. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

## VËREN SE :

### IV. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

Referuar “Marrëveshje për transferimin e kuotave” (draft), 02 mars 2023, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, e cila operon në biznesin e ndërtimit dhe furnizimit me energji të rinovueshme për klientët.

Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited është një filial i Statkraft IH Holdings AS, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë dhe objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme.

Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit

e grupit Statkraft), shoqëri në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike..etj.

*Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisë prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Pala shitëse: Enel Green Power India Private Limited**, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë.

**Shoqëria Target: Khidrat Renewable Energy Private Limited**, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, e angazhuar në ndërtimin, operimin dhe furnizimin me energji nga dielli për klientët. Khidrat Renewable Energy Private Limited zotërohet nga shoqëria Enel Green Power India Private Limited dhe Z. Sandy Khera.

Target nuk ka prezencë dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

## **V. Përqendrimi**

Referuar dokumentacionit të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe “Marrëveshje për transferim kuotash” (draft), 02 mars 2023, rezulton se Shitësi dhe ortaku i nominuar i shitësit (Z. Sandy Khera) kanë rënë dakord t’i shesin blerësit kuotat dhe blerësi, duke u mbështetur në garancinë e shitësit; marrëveshjet dhe detyrimet e tjera të ndërmarra nga shitësi dhe ortaku i nominuar i shitësit, ka rënë dakord të blejë nga shitësi dhe ortaku i nominuar i shitësit, kuotat e shitjes.

Pas përfundimit të shitjes dhe blerjes së kuotave në datën e mbylljes, blerësi do të zotërojë 100% shoqërinë Khidrat Renewable Energy Private Limited.

Referuar draft-marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, do të përbëjë një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar nën 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 60 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

## **VENDOSI:**

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



**VENDIM**

**Nr. 966, Datë 17.03. 2023**

**“PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17. 03. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i kërkesës për shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

**Baza Ligjore:** Neni 4, 5, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; ligji nr. 44/2015 “ Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

**VËREN SE :**

**I. Procedura e ndjekur dhe Marrëveshja**

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 786, datë 25.03.2021 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”, vendosi:

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi; Nëpërmjet shkresës nr.96, prot i AK, datë 06.02.2023, “Kërkesë për zgjatjen e afatit të përjashtimit individual të marrëveshjes kufizuese ndërmjet Philip Morris Products S.A/ KT&G Corporation”, përfaqësuesi ligjor i shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës kërkesën e zgjatjes së Përjashtimit Individual, të dhënë me Vendimin e përjashtimit nga ndalimi, për një afat kohor shtesë deri në fund të periudhës fillestare të Marrëveshjes, 26 tetor 2023.

Pika 4 e nenit 50 “Vendimi për përjashtime individuale”, e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” parashikon se: *Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarohen pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata*

bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.

### ***Marrëveshja***

Më datë 29 janar 2020, ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT & G Corporation u nënshkrua një marrëveshje e përbashkët tregtare (marrëveshje distribucioni), sipas së cilës Philip Morris Products S.A, ekskluzivisht, do të tregtonte dhe të shiste produkte “smoke –free” të KT & G Corporation jashtë Koresë së Jugut në këmbim të të ardhurave bazuar në shitjet e produkteve të konsumit të KT&G Corporation dhe KT&G Corporation & Philip Morris Products S.A.

Philip Morris Products S.A. përfitoi një licencë ekskluzive në lidhje me pronësinë intelektuale dhe markën KT&G Corporation. Marrëveshja i lejonte Philip Morris Products S.A të shpërndante produkte “smoke –free” si dhe produkte që janë evolucion i produkteve “smoke –free” të KT&G Corporation mbi një bazë ekskluzive dhe nuk kufizonte Philip Morris Products S.A në shpërndarjen e produkteve të veta ose të palëve të treta.

Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte të maksimizonte potencialin për shitjet e produkteve të KT&G Corporation jashtë Koresë dhe se përdorimi ekskluziv i rrjetit të marketingut, shitjeve dhe shpërndarjes së Philip Morris Products S.A do të ishte i domosdoshëm për arritjen e këtij qëllimi dhe për rrjedhojë i domosdoshëm për arritjen e kësaj efijence dhe përfitimeve për konsumatorët.

Në vendimin nr. 786/2021, Komisioni i Konkurrencës e klasifikoi Marrëveshjen e njoftuar si një marrëveshje horizontale mes shoqërive të cilët janë konkurrentë në treg dhe që merren me tregtimin dhe shitjen e produkteve pa tym në tregun e cigareve.

Në zbatim të nenit 5 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të cilin parashikohet përjashtimin individual i marrëveshjeve nga zbatimi i nenit 4 të tij dhe Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”, kjo marrëdhënie u vlerësua si marrëveshje horizontale me efekte vertikale.

*Philip Morris Products S.A* (PMI) është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e produkteve të duhanit, i të gjitha produkteve që përmbajnë nikotinë dhe i pajisjeve dhe aksesorëve që lidhen me to.

PMI është prezente në Shqipëri në mënyrë indirekte që nga viti 2006, përmes Philip Morris Albania SHPK, një filial i plotë i Philip Morris SA, e cila është e angazhuar në blerjen, importimin, shitjen dhe eksportimin e produkteve të duhanit nën markat Philip Morris, Marlboro, Merit dhe L&M, si dhe mallrave të konsumit duke përfshirë pajisjet elektrike.

*KT&G Corporation* është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit korean, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e cigareve dhe materialeve në lidhje me to, prodhimin dhe shitjen e ushqimeve dhe pijeve dhe gjithashtu është e specializuar në fushën e biofarmaceutikes dhe produkteve të bukurisë. Markat kryesore të KT & G përfshijnë Esse, Carnival, Pine dhe LIL/FIIT.

KT&G Corporation nuk ka degë apo filial në Shqipëri.

## **II Analiza e Konkurrencës**

Në Shqipëri, produktet konvencionale të duhanit (dhe veçanërisht cigaret) përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të tregut të produkteve që përmbajnë nikotinë. Produktet alternative/produktet pa djegie që përmbajnë nikotinë janë një segment i tregut në zhvillim, me dinamizëm dhe inovacion të vazhdueshëm, krahasuar me produktet konvencionale. Ekzistojnë ngjashmëri dhe ndryshime të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë dhe produkteve konvencionale të duhanit, me një trend të rritjes së pranisë së tyre në treg dhe kalimit nga produktet konvencionale në ato alternative nga konsumatorët.

Në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga tregut përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik.

Referuar analizës së tregut përkatës, në raportin e vlerësimit të përjashtimit nga ndalimi të kësaj

marrëveshje, tregu përkatës i produktit u përcaktua **tregu i shitjes me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë** dhe përkatës gjeografik u përcaktua **territori kombëtar i Republikës së Shqipërisë**.

Bazuar në vlerësimet e brendshme të shoqërisë PMI konstatohet se tregu i produkteve pa djegie, gjatë periudhës së përjashtimit (2020-2022), vazhdon të jetë një treg shumë i vogël krahasuar në tregun e shitjes së cigares tradicionale duke zënë gjatë vitit 2020 rreth XX % , vitit 2021 rreth XX% dhe vitit 2022 rreth XX% të gjithë tregut të cigareve, por me dinamika në rritje në tre vitet e fundit.

Pjesa e tregut që zë PMI në tregun e produkteve pa djegie ka qenë XX% për vitin 2020, XX% për vitin 2021 dhe XX% për vitin 2022. Nga vlerësimet e mësipërme është e qartë se hedhja në tregun shqiptar të produkteve KT&G nga PMI më 9 gusht 2021, nuk ka pasur ndonjë efekt negativ në produktet pa djegie, pasi pjesëmarrja në treg e PMI në segmentin në fjalë ka rënë pas hedhjes në treg të produkteve përkatëse sipas Marrëveshjes.

Si rrjedhojë, hedhja në treg e produkteve KT&G në tregun shqiptar nga PMI nuk pati ndonjë efekt negativ në hyrjen apo rritjen e konkurrentëve aktualë apo potencialë në Shqipëri.

Gjithashtu, nga këndvështrimi i kërkesës dhe në veçanti nga këndvështrimi i përdoruesve të duhanit që kanë mbushur moshën ligjore, produktet pa djegie që përmbajnë nikotinë janë relativisht produkte të reja, në zhvillim të vazhdueshëm dhe të mbështetur nga konkurrenca e ashpër. Shkalla e zëvendësueshmërisë midis këtyre produkteve dhe produkteve tradicionale me djegie të duhanit është e kufizuar dhe asimetrike, pasi përdoruesit e produkteve me djegie mund të kalojnë në produkte pa djegie që përmbajnë nikotinë, por përdoruesit e produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë nuk do të kalojnë domosdoshmërisht në cigaret tradicionale, puro etj.

Periudha e propozuar për shtyrjen e përjashtimit të marrëveshjes, deri më datë 26 tetor 2023, nuk pritet të sjellë ndryshime të ndjeshme në strukturën e tregut të shitjes me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë dhe për këtë arsye miratimi i shtyrjes së përjashtimit nuk do të sjellë efekte mbi konkurrencën në treg.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenit 50, pika 4, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I.** Të shtyjë afatin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation, deri në datë 26 tetor 2023.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 967, Datë 24. 03. 2023

### “ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FG SOUTH EAST EUROPE S.A. NGA SHOQËRIA FUJITSU GENERAL (EURO) GMBH”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 03. 2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. nga shoqëria FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. nga shoqëria FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH.

## VËREN SE :

### I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfitimin e kontrollit të shoqërisë FG South East Europe S.A nga shoqëria FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, të nënshkruar më datë 09 nëntor 2022, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: prodhimin, blerjen dhe rishitjen e artikujve teknikë, veçanërisht të pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe aksesorëve të tyre përkatës, përfshirë këtu përpunimin e pjesshëm ose përpunimin e plotë, si dhe importimin ose eksportimin e tyre.

FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH kontrollohet 100% nga FUJITSU GENERAL LIMITED, Japoni, shoqëria mëmë, e cila operon në tregjet e prodhimit dhe shpërndarjes së kondicionerëve, sistemet e informacionit dhe komunikimit dhe të pajisjeve elektronike.

FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH nuk ka asnjë filial në Shqipëri.

**Pala shitëse: SILANER INVESTMENTS LIMITED** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Qipros.

**Shoqëria Target: FG SOUTH EAST EUROPE S.A.** është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjeve të Greqisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin me mjetet e veta, prodhimin, montimin, importin, eksportin, përfaqësimin dhe asgjësimin për fitim (tregtimi) i pajisjeve elektrike si kondicionerët, pajisjet elektrike të bardha dhe pajisjet e telefonisë celulare, ofrimin e shërbimeve të hulumtimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve informatike IT-së, etj.

FG SOUTH EAST EUROPE S.A. është themeluar në bazë të një shkëputje të pjesshme (spin-off) të shoqërisë me emrin tregtar FG Europe SA, sipas parashikimeve të ligjit grek 4601/2019 “Për transformimet e shoqërive” dhe ka trashëguar biznesin e ajrit të kondicionuar të shoqërisë FG Europe SA, për rrjedhojë, aksionarët e të dyja shoqërive janë të njëjtë. Shoqëria SILANER INVESTMENTS LIMITED zotëron 48,02 % të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shoqëria Target nuk ka filial në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura në Shqipëri nga shitja e pajisjeve të kondicionimit, nëpërmjet konsumatorëve/partnerëve.

## II. Përqendrimi

Ndërmjet SILANER INVESTMENTS LIMITED (shitësi) dhe shoqërisë FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH (blerësi) është lidhur “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, datë 09 nëntor 2022.

Referuar kësaj Marrëveshjeje, shitësi merr përsipër detyrimin për të shitur dhe transferuar tek blerësi dhe anasjelltas, Aksionet e Shitjes të lira nga çdo pretendim dhe çdo barrë së bashku me të gjitha të drejtat, titujt ose interesat bashkangjitur tyre.

Blerësi është i interesuar të blejë nga shitësi 2.315.523 aksione të regjistruara, të zakonshme dhe me të drejtë vote, që përbëjnë 46,59% të kapitalit aksionar të paguar të shoqërisë.

Duke qenë se blerësi zotëron aktualisht 4.41% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, pas mbylljes së transaksionit, ai do të zotërojë 51% të kapitalit aksionar të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. duke përfutur kontrollin mbi shoqërinë target.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## III. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu prodhimit të kondicionerëve, pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve telefonike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundi i kontrollit të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. nga shoqëria FUJITSU GENERAL (EURO) GmbH. Blerësi dhe Targeti nuk kanë filiale në Republikën e Shqipërisë.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë

ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- III.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FG SOUTH EAST EUROPE S.A. nga shoqëria FUJITSU GENERAL (Euro) GmbH.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 968, Datë 24. 03. 2023**

**"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOSSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE PEEL NRE WIND FARMS (YELL) LIMITED DHE PEEL NRE WIND FARMS (NO.1) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD".**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

**Bazë ligjore:** Nenet 2. 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarreve": Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

**VËREN SE:**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd. Referuar dokumentacionit të paraqitur, palët janë:

**Pala blerëse:** Statkraft UK Ltd. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: Zhvillimi dhe operimi i projekteve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe të furnizimit me energji. Statkraft UK Ltd zotërohet 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e Grupit Statkraft), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë në Evropë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V: Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devoll Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

**Pala shitëse: Peel NRE Renewables (IOM) Limited**, është një shoqëri e kufizuar në kuota, me adresë në Billown Mansion, Isle of Man.

**Shoqëritë Target: Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited** janë shoqëri të themeluara sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: Zhvillimin e dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.

Shoqëritë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited. zotërohen 100% nga shoqëria Peel NRE Renewables (IOM) Limited. Shoqëritë Target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

## **II. Përqendrimi**

Referuar dokumentacionit zyrtar të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se: Blerësi Statkraft UK Ltd është në proces negociimi të lidhjes së Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve me shitësin Peel NRE Renewables (IOM) Limited. Pas lidhjes së kësaj Marrëveshje. me përmbushjen e kushteve të mbylljes (të cilat do të përkufizohen në Marrëveshje), shitësi do të shesë të gjitha aksionet e zotëruara në kapitalin e shoqërive target, Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited.

Shitësi është i angazhuar në një proces shitje në ankand nëpërmjet këshilltarëve të tij financiar të projekteve të fermave të erës dhe blerësi është zgjedhur pas këtij procesi si ofertues i preferuar. Pas marrjes së autorizimit nga Autoriteti i Konkurrencës palët synojnë të mbyllin sa më shpejt transaksionin. Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited, nga shoqëria Statkraft UK Ltd. e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes dhe plotësimit të Kushteve Paraprake. Referuar dokumentacionit si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të mjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhenien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d. nenit 56 pika 1 dhe nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",



**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 date 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

## VENDIM

Nr. 969, Datë 24. 03. 2023

### “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”.

**Bazë ligjore:** Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos dhe;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak,

### VËREN SE:

#### I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë vitit 2022 ka monitoruar tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, me Vendimin nr. 895, datë 05.07.2022, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore 1 Janar 2021 deri në 30 Qershor 2022.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 468/18, datë 18.07.2022, "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë periudhës së hetimit paraprak kryen inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.
4. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë

periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## II. ANALIZA E KONKURRENCËS

### II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.06.2008, “Për përcaktimin e Tregut Përkatës”, Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *“Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”*.
8. Çimento mund të ndahet në dy lloje sipas destinacionit final të përdorimit:
  - *Çimento e bardhë* – ka në përbajtjen e saj gëlqere dhe sasi të vogël hekuri dhe gips. Kjo lloj çimento përdoret për punë arkitekturore, për fasada apo skulptura.
  - *Çimento gri* – ka në përbajtjen e saj klinker. Kjo lloj çimento është më e përdorur në ndërtim apo kryesisht në prodhimin e betonit. Çimento gri është e ndarë në disa klasa, duke filluar nga 32.5, 42.5 dhe 52.5.
7. Referuar faktorëve të vlerësimit të tregut përkatës si zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe ofertës, homogjenitetit të produktit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të produkteve, si dhe duke u nisur nga pjesa që zë shitja e çimentos gri 32.5 me thasë dhe çimentos gri 42.5 rifuxho dhe me thasë ndaj sasisë totale të çimentos së ofruar nga ndërmarrjet në treg, për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është: Tregu i importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri, i ndarë në nën tregje sipas produkteve:
  - a) Nëntregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento 32.5 e paketuar me thasë;
  - b) Nëntregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento 42.5 e paketuar me thasë;
  - c) Nëntregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento 42.5 rifuxho.
8. Prodhimi, importi dhe shitja me shumicë e produktit çimento realizohet nga ndërmarrje, të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

### II.3 Struktura e tregut

9. Tregu i çimentos gri në Shqipëri është një treg i përbërë nga katër kompani prodhuese që janë: “Antea Cement” SHA, “Elbasan Cement Factory” SHPK, “Fushë Kruja Cement Factory” SHPK dhe “Colacem Albania” SHPK, si dhe dy ndërmarrje importuese të produktit, përkatësisht ndërmarrjet: “Eurotech Cement” SHPK, dhe “Bërdica Cement” SHPK.

10. Nga të dhënat vërehet se importi i çimentos së bardhë realizohet në pjesën më të madhe nga ndërmarrja Berdica Cement, përkatësisht 88.3 % e importit të këtij produkti për vitin 2021 dhe rreth 98 % të importit të çimentos së bardhë për periudhën Janar – Qershor 2022. Ndërmarrjet e tjera zënë një pjesë të vogël të importit të çimentos së bardhë, ndër të cilat ndërmarrja Antea Cement e cila zinte rreth 8% të importit të këtij produkti për vitin 2021, për periudhën Janar – Qershor 2022 ka importuar vetëm një sasi të vogël çimento të bardhë.
11. Sasia e çimentos e marrë në analizë në tregun përkatës, përkatësisht çimento me thasë 32.5, çimento me thasë 42.5 dhe çimento Rifuxho 42.5, zë nga 97-100% të sasisë totale të shitur nga secila nga ndërmarrjet brenda vendit për vitin 2021, dhe pjesën nga 52-100% të sasisë totale të shitur nga secila nga ndërmarrjet brenda vendit për periudhën janar – qershor 2022.
12. Për vitin 2021 ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut, *referuar shitjeve brenda vendit*, është ndërmarrja Antea Cement me 45% të tregut. Ndërmarrja Fushë Kruja Cement për vitin 2021 zë rreth 31% të sasisë totale të shitur brenda vendit, e ndjekur nga ndërmarrja Colacem Albania me rreth 13% të tregut. Ndërmarrja Eurotech Cement për vitin 2021 zë rreth 8% të tregut ndërsa ndërmarrja Elbasan Cement me 6% të sasisë totale të shitur brenda vendit. Gjithashtu për vitin 2021 vërehet dhe një ndërmarrje e re importuese Bërdica Cement e cila zënë 1% të tregut.
13. Për vitin 2021, *referuar sasisë totale të importuar, prodhuar dhe eksportuar*, ndërmarrja me pjesën më të madhe mbetet Antea Cement me 43% të tregut e ndjekur nga ndërmarrja Fushë Kruja Cement me 36% të tregut. Ndërmarrja Colacem Albania për vitin 2021 zotëron 11% të tregut, Elbasan Cement me 5% të tregut dhe Eurotech Cement 4% të sasisë totale të tregut të çimentos.
14. Për periudhën janar – qershor 2022, *referuar shitjeve brenda vendit*, ndërmarrja me pjesën më të lartë të tregut vazhdon të mbetet Antea Cement me 58%. Ndërmarrja Fushë Kruja Cement zë rreth 15% të sasisë totale të shitur brenda vendit, Colacem Albania me 13% të tregut, Eurotech Cement 8 % të tregut dhe Elbasan Cement me 6% të tregut.
15. *Referuar sasisë totale të importuar, prodhuar dhe eksportuar* për periudhën janar – qershor 2022, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut vazhdon të mbetet Antea Cement me 57%. Ndërmarrja Fushë Kruja Cement zotëron pjesën prej 19% të tregut, Colacem Albania me 12% të tregut, ndërmarrja Elbasan Cement me 6% të tregut dhe Eurotech Cement Albania me 5% të tregut.
16. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos konstatohet se ndërmarrja Antea Cement SHA zotëron pjesën prej 45% të tregut për vitin 2021. Edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2022, pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje mbetet e lartë me 58%, mbi kufirin 40% i cili është një nga treguesit e një ndërmarrje me pozitë dominuese në treg.
17. Treguesit e përqendrimit paraqesin një treg shumë të përqendruar dhe përsa i takon treguesve në lidhje me fuqinë në treg të ndërmarrjeve më të mëdha, treguesi është mbi 85% për vitin 2021.

#### **II.4 Vlerësimi i pozitës dominuese**

18. Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Duke qenë se ndërmarrja Antea Cement paraqitet me një pjesë tregu më të madhe se 40% në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos, është bërë vlerësimi i pozitës dominuese të kësaj ndërmarrjeje në tregun përkatës, bazuar në nenin 8, të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve në treg janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve të blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes etj.; karakteristika të tjera të tregut përkatës.

19. Ndërmarrja Antea Cement zotëron 45% të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë referuar tre llojeve të çimentos (32.5 me thasë, 42.5 me thasë dhe 42.5 rifuxho), duke qenë ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2021. Edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2022, pjesa e tregut të shitjes me shumicë të kësaj ndërmarrje mbetet e lartë me 58%, mbi kufirin 40% i cili është një nga treguesit e një ndërmarrje me pozitë dominuese në treg. Megjithatë në tregun e shitjes me shumicë të çimentos operojnë edhe ndërmarrje të tjera me pjesë tregu të konsiderueshme si Fushë Kruja Cement Factory, etj., gjë e cila bën që të këtë konkurrencë potenciale. Gjithashtu një ndërmarrje me pjesë të madhe tregu nuk mund të veprojë e pavarur nga klientët që zotërojnë fuqi të mjaftueshme tregu. Në rastin tonë klientët kanë mundësi për të kaluar drejt furnizuesve të tjerë konkurrentë.
20. Tregu i prodhimit të çimentos në Shqipëri ka barriera ligjore në hyrje të tilla si vështirësitë e marrjes së lejeve përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, Lejet Mjedisore për instalimet e tyre të cilat mund të ndikojnë në shkarkimet dhe ndotjen etj., si dhe barriera ekonomike në formën e investimeve të larta në fabrikat e prodhimit të çimentos.
21. Referuar të dhënave ekonomike të ndërmarrjeve nën hetim rezultojnë se për vitin 2021 ndërmarrjet prodhuese dhe importuese të çimentos kanë një normë fitimi nga -0.7% në 11.2%. Ndërmarrja Elbasan Cement Factory rezultojnë me humbje, ndërsa Antea Cement SHA është ndërmarrja me fitimin më të lartë për vitin 2021.
22. Në përfundim të analizës, duke marrë parasysh pjesën e tregut të ndërmarrjes Antea Cement, barrierat për hyrjen në treg, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Antea Cement SHA, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë të çimentos.
23. Sipas ligjit nr. 9121/2003, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të ligjit 9121/2003.

### **II.3 Sjellja e ndërmarrjeve në treg**

24. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.9121/2003 janë analizuar faturat e shitjes dhe blerjes së të gjitha ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë aktivitet në këtë treg për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës si pasoje e marrëveshjeve të ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve, si çmime të fiksuara, ndarje e tregjeve etj. duke marrë në analizë çmimet mesatare mujore të produktit çimento me thasë 32.5, çimento me thasë 42.5 dhe çimento rifuxho 42.5 për të gjitha ndërmarrjet nën hetim.
25. Nga analizimi i çmimeve mesatare mujore të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të produktit çimento vërehet se të gjitha ndërmarrjet në muajin mars të vitit 2022 kanë rritur çmimin e shitjes për të gjitha produktet në të njëjtën masë të konsiderueshme dhe masa e ndryshimit që ka pësuar çmimi i shitjes për secilën ndërmarrje është realizuar në të njëjtën periudhë.
26. Referuar çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet për produktin çimento 32.5 me thasë vërehet se ritmi i ndryshimit të çmimeve të ndërmarrjeve është i njëjtë për të gjithë periudhën,

duke reflektuar një rritje të konsiderueshme në periudhën mars – qershor 2022 dhe trendi i rritjes së çmimit të aplikuar nga ndërmarrjet është i njëjtë.

27. Nga analizimi i çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet për produktin çimento 42.5 rifuxho vërehet se ritmi i ndryshimit të çmimeve të ndërmarrjeve është i njëjtë për të gjithë periudhën, duke arritur një rritje të konsiderueshme për të gjitha ndërmarrjet nën hetim e cila varion nga 40% deri në 60%. Ndërmarrja Antea Cement SHA aplikon çmime më të larta shitje për produktin çimento 42.5 rifuxho sesa ndërmarrjet e tjera në tregun përkatës, si dhe gjatë periudhës janar qershor 2022 masa e rritjes së çmimit të shitjes është më e madhe se konkurrentët e tjerë në treg.
28. Nga analiza e çmimeve të shitjes vërehet se ritmi i ndryshimit të çmimeve të ndërmarrjeve është i njëjtë për të gjithë periudhën, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme në periudhën mars – qershor 2022 dhe trendi i rritjes së çmimit të aplikuar nga ndërmarrjet është i njëjtë, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtën e konkurrencës”.
29. Në përfundim të analizës së realizuar gjatë periudhës hetimore, duke marrë parasysh kriteret e vlerësimit të pozitës dominuese si: pjesën e tregut të ndërmarrjes Antea Cement SHA; barrierat për hyrjen në treg; fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja Antea Cement SHA, vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë të çimentos gri. Gjithashtu ndërmarrja Bërdica Cement zotëron rreth 89% të tregut të importit të çimentos së bardhë.
30. Referuar analizës së tregut të prodhimit dhe shitjes së produktit çimento rezulton se nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg vërehen elementë të cilët mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me pasojë për konkurrencën në treg.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 4 dhe 9, 24 shkronja d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri dhe të bardhë.
- II. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janari 2019 deri në 31 Mars 2023.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 970, Datë 24. 03. 2023**

**“Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësimi i Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, lidhur ndërmjet: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 4, neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin e Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi”;
- Shpjegimet e dhëna nga përfaqësues të: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (këtu e në vijim DPSHTRR), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (këtu e në vijim DPT), Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, si dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”, në seancat dëgjimore të zhvilluara pranë AK-së më datë 17.03.2023, si dhe dokumentacionit të depozituar nga DPSHTRR, në vijim të seancës dëgjimore me shkresën nr. 3532/3 prot., datë 16.03.2023, me lëndë “Kthim përgjigje Vendimit nr. 964, datë 01.03.2023 dhe dërgim praktike shkresore lidhur me Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 2729 prot., datë 13.02.2023”;

**VËREN SE:**

**II. Procedura e ndjekur:**

1. Autoriteti i Konkurrencës, nisur nga njoftimi i bërë në median e shkruar më datë 21 shkurt 2023, për një marrëveshje ndërmjet Grupeve të interesit përfaqësues të autoshkollave (Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave” dhe Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë”), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në lidhje me përcaktimin e kostos minimale fiskale (tarifat e pagesës) së përgatitjes për drejtues mjeti, bazuar në

nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka filluar procedurat e vlerësimit të kësaj marrëveshje. Në kuadër të këtij vlerësimi, me anë të shkresës nr. 147 prot., datë 22.02.2023, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. Me shkresën nr. 3532/1 prot., datë 23.02.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (protokolluar pranë AK me nr. 147/1 prot, datë 24.02.2023) pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshkollave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
3. Nga vlerësimi paraprak i Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, rezultoi se, në kuptim të këtij nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, nënshkruar ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshkollave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila përcakton tarifën e pagesës dhe koston referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës.
4. Në respektim të nenit 44 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se jemi përpara një rasti urgjence, pasi Akt Marrëveshja për përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, nëpërmjet përcaktimit të tarifës minimale ka rrezik të sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në ofrimin e këtyre shërbimeve, duke reduktuar seriozisht përfitimet që tregjet konkurruese ofrojnë për konsumatorët.
5. Bazuar sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 964, datë 01.03.2023, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi”, vendosi:
  - I. Marrjen e masave të përkohshme ndaj palëve nënshkruese të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si vijon:
    1. Ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi;
  - II. Depozitimin pranë AK-së të të gjithë praktikës së ndjekur deri në nënshkrimin e kësaj Akt Marrëveshjeje, për të kryer vlerësimin ligjor të saj, bazuar në nenin 4, nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;  
Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës administrative dhe marrjen e vendimit përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës.
  - III. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, germa b), të Ligjit nr. 9121/2003.
6. Në vijim të procedurës së vlerësimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, bazuar në VKK nr. 964, datë 01.03.2023, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e zbatimit të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, në lidhje me përcaktimin e tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39, “E drejta e palëve për t’u dëgjuar”<sup>1</sup>, të ligjit nr. 9121/2003, më datë 17.03.2023

<sup>1</sup> Shkresa e AK nr. 147/3, prot., datë 01.03.2023, “Ftesë për seancë dëgjimore”.



zhvilloi seancën dëgjimore me përfaqësues të: Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Shoqatës “Kombëtare të Autoshtokollave”, si dhe Shoqatës së Autoshtokollave “Siguria në rrugë”, lidhur me Akt Marrëveshjen nr. 2729 prot., datë 13.02.2023.

7. Në vijim të seancës dëgjimore, në përmbushje të pikës II të VKK nr. 964/2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet shkresës nr. 3532/3 prot., datë 16.03.2023, me lëndë “Kthim përgjigje Vendimit nr. 964, datë 01.03.2023 dhe dërgim praktike shkresore lidhur me Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 2729 prot., datë 13.02.2023”<sup>2</sup>, është depozituar pranë AK-së praktika shkresore e ndjekur deri në nënshkrimin e Akt Marrëveshjeje nr. 2729 prot., datë 13.02.2023.

### III. Qëndrimi i DPSHTRR

8. Roli i DPSHTRR lidhur me veprimtarinë e autoshtokollave, përcaktohet në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 115, pika 2, sipas të cilit: *“Përgatitja e kandidatit për lejedrejtimi bëhet në autoshtokolla dhe provimet e aftësisë për lejedrejtimi duhet të bëhen pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, pasi të plotësohen kushtet e caktuara fizike e mendore...”*. Gjithashtu në nenin 121, pika 2, të Kodit Rrugor, përcaktohet se: *“Mbikëqyrja administrative dhe teknike e veprimtarisë së autoshtokollave ushtrohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bazë të akteve të nxjerra nga ministria që mbulon veprimtarinë”*.
9. Në nenin 313 të VKM nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se: *“2. Përgatitja e drejtuesve të mjeteve rrugore me motor bëhet vetëm në autoshtokolla, kundrejt pagesës. Tarifa e pagesës përcaktohet nga subjektet, juridike e fizike, shtetërore dhe private, që organizojnë autoshtokollën... 5. Kohëzgjatja e kurseve për përgatitjen teoriko-praktike në autoshtokollë përcaktohet nga lloji i lejes së drejtimit, në mbështetje të akteve nënligjore, të nxjerra nga ministria përgjegjëse për transportin rrugor. 6. Për përgatitjen e plotë, teorike dhe praktike, të kandidatëve, subjektet që organizojnë autoshtokollat duhet të realizojnë programet e teorisë dhe të praktikës, të hartuara dhe të miratuara nga ministria përgjegjëse për transportin rrugor.”*
10. Sipas qëndrimit të DPSHTRR, objekt i Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023 është: *“Njohja ndërmjet Palëve me tarifën e pagesës, si dhe vlerësimin e kostos minimale fiskale referuese, për përmbushjen e programit të edukimit për përgatitjen për drejtues mjeti dhe pajisjen me kategoritë e lejedrejtimit: AM, A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E, DE, për përgatitjen për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj, si dhe përgatitjen për pajisjen me dëshmitë dhe certifikatat e aftësisimit profesional”* dhe jo përcaktimi i tarifës së pagesës dhe kostos minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi.
11. Sipas DPSHTRR, kjo marrëveshje nuk ka qëllim pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës së tregut, si dhe as caktimin e çmimeve të përcaktuara të blerjes apo shitjes, pasi analiza e kostos minimale fiskale në përlllogaritjen e tarifës (sipas nenit 2, të marrëveshjes), është një vlerë referuese për efekt fiskal, mbi gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetin “Autoshtokollë” në RSH. DPSHTRR shprehet se kjo analizë ka marrë në konsideratë elementet e kostos reale të tregut dhe

<sup>2</sup> Protokolluar pranë AK me nr. 174/4 prot., datë 17.03.2023.

vetëm kostot e justifikuara, thuajse në vlerat minimale të orientuara drejt kostove të shërbimeve, për realizimin e detyrueshëm të programit mësimor teorik, praktik dhe pajisjen me lejedrejtimi. Në këtë tarifë përfshihen edhe kostot minimale fiskale, TVSH, fitimi dhe vlera 18% e kostove administrative (KA) të pajisjes me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 311 të VKM nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”. ... kjo marrëveshje synon reformimin total të aktivitetit të autoshkollave, deri në dhënien fund të evazionit, fiktivitetit, informalitetit dhe rrezikut potencial në qarkullimin rrugor.

12. DPSHTRR shprehet se: Kjo marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi dhe nuk ka prodhuar pasoja dhe efekte në treg.... *Tarifa e pagesës, e kërkuar sipas VKM-së nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuarr, dhe udhëzimit të MIE nr. 9/2022, “Për aktivitetin e autoshkollave”, është njohëse dhe referuese. Operatorët në treg i caktojnë vetë çmimet apo të ashtuquajturën tarifë, por tashmë organet mbikëqyrëse kanë një strukturë kostoje për t’u analizuar.*
13. Bazuar sa më sipër, pranë DPSHTRR janë depozituar kërkesat e shoqatave (grupet e interesit) me anë të të cilave kërkohet zbatimi i udhëzimit, si dhe janë përcjellë tabelat me çmimet e programit për përgatitjen për drejtues mjeti të kategorive të lejedrejtimin pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj, si dhe përgatitjen për pajisjen me dëshmitë dhe certifikatat e aftësisë profesionale. Gjithashtu midis DPT, DRSHTRR dhe grupeve të interesit janë mbajtur korespondenca dhe janë zhvilluar disa takime gjatë vitit 2022 dhe 2023, deri në hartimin e draftit përfundimtar të Akt Marrëveshjes.
14. Nga korespondenca e përcjellë pranë AK, sa i përket qëndrimit të DPT-së rezulton se nga ana e DPT janë bërë disa sugjerime lidhur me: kryerjen e pagesës nga kandidatët për leje drejtimi për përgatitjen e njohurive teorike dhe për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes nëpërmjet sistemit bankar; mos përfshirjen në koston minimale fiskale të tarifave që derdhen për llogari të DPSHTRR, etj.
15. Në zbatim të legjislacionit tatimore, DPT aplikon mbi autoshkollat detyrimet si tatimpagues në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi të ardhurat dhe fiskalizimin. Konkretisht, në nenin 46 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se:
  - “1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.
  2. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku regjistrohen:
    - a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
    - b) veprimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;
    - c) veprimet e patatueshme;
    - ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit.
  3. Tatimpaguesi nuk është i detyruar të mbajë regjistra të veçantë, sipas pikës 2, të këtij neni, për të cilët administrata tatimore harton raporte automatike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.”
16. Në nenin 29 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se:

“1. Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Për efekte fiskale, të dhënat e dokumenteve të mësipërme quhen të pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumën e përcaktuara sipas nenit 37 të këtij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.”

17. Bazuar sa më sipër legjislacioni përkatës tatimor përcakton qartë mënyrat dhe mjetet për përmbushjen e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, pa qenë nevoja e një ndërhyrjeje të drejtpërdrejt nga ana e DPT-së për llogaritjen e një kostoje minimale fiskale si vlerë referuese për efekt fiskal.

#### IV. Vlerësimi ligjor i Akt Marrëveshjes

18. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si institucion shtetëror, është person juridik, publik, jobuxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet, e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 21.07.1999, "Për krijimin e DPSHTRR".
19. Kompetencat, detyrat dhe të drejtat e DPSHTRR-së përcaktohen në statutin e kësaj drejtorie, i cili miratohet nga ministri përgjegjës. Objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie, sipas nenit 2 të Statutit të saj, është *shërbimi ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor*. Tarifat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor miratohen nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor (Nëni 6 i Statutit).
20. Kërkesat dhe procedurat për marrjen e lejedrejtimit të mjetit përcaktohen në nenet 119 - 120 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", nenet 310 dhe 311 të VKM nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 14.4.2022, "Për aktivitetin e autoshkollave".
21. Bazuar në nenin 119 të Kodit Rrugor të RSH, lejedrejtimi i mjetit merret pas provës së kontrollit të njohurive teorike dhe pas provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes. Provimet për marrjen e lejedrejtimit kryhen në bazë të udhëzimeve, mënyrave dhe programeve të përcaktuara nga ministri përgjegjës për transportin.
22. Referuar nenit 121, pika 1, e Kodit Rrugor dhe nenit 313 të VKM nr.153/2000, autoshkollat janë shkolla për edukimin rrugor, instruktimin dhe formimin e drejtuesve të mjeteve dhe *ushtrohen si aktivitet i lirë privat*. Licencimi i tyre bëhet sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duke respektuar kriteret teknike dhe profesionale. *Rregullat dhe detyrimet për funksionimin e autoshkollës*, kërkesat e përshtatshmërisë për mësuesit dhe instruktorët e autoshkollave për drejtues mjeti, kushtet për lokalet dhe pajisjet didaktike që mundësojnë zhvillimin normal të provimeve dhe garantojnë kohëzgjatjen e kurseve, përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij Kodi nga ministri përgjegjës për transportin rrugor.

23. Neni 313 i VKM nr.153/2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” parashikon se:

“Përgatitja e drejtuesve të mjeteve rrugore me motor bëhet vetëm në autoshkolle, kundrejt pagesës. *Tarifa e pagesës përcaktohet nga subjektet, juridike e fizike, shtetërore dhe private, që organizojnë autoshkollet.*” (pika 2 e nenit).

“Për përgatitjen e plotë, teorike dhe praktike, të kandidatëve, subjektet që organizojnë autoshkollet duhet të realizojnë programet e teorisë dhe të praktikës, të hartuara dhe të miratuara nga ministria përgjegjëse për transportin rrugor.” (pika 6 e nenit).

24. Autoshkollet funksionojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas rregullave dhe detyrimeve të përcaktuara me akte nënligjore nga ministri përgjegjës për transportin rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën mbikëqyrjen administrative dhe teknike të veprimtarisë së autoshkolleve, bazuar në aktet e nxjerra nga ministria që mbulon veprimtarinë. DPSHTRR-ja ka të drejtën dhe detyrimin në bazë të Kodit Rrugor (pika 3, neni 121) që të pezullojë veprimtarinë e autoshkolles, për një periudhë nga 1 deri në 3 muaj, në rastet kur:

- a) *veprimtaria nuk zhvillohet rregullisht;*
- b) *titullari nuk merr masa për zëvendësimin e mësuesve dhe të instruktorëve, që janë vlerësuar të papërshtatshëm nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;*
- c) *titullari nuk respekton urdhrat e dhënë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të rregulluar funksionimin e autoshkolles;*
- d) *bëhet transferimi i mjediseve të autoshkolles pa lejen e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.*

25. Gjithashtu në Kodin Rrugor (neni 121, pika 4) përcaktohen edhe rastet kur licenca e një autoshkolle anulohet nga organi që e ka lëshuar, pas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

26. Në zbatim të këtij Kodi, DPSHTRR harton programet e provimeve për marrjen e lejedrejtimit, si organi i vetëm që lëshon lejedrejtimin.

27. Për marrjen e lejedrejtimit<sup>3</sup>, personi i interesuar, pas dorëzimit të dokumenteve të nevojshme në një autoshkolle të licencuar, regjistrimit nga përfaqësuesi i autoshkolles në sektorin përkatës të DPSHTRR-së, *si dhe pas pagesës së tarifave përkatëse, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportet, pajiset me leje për vazhdimin e kursit teorik të përgatitjes për kategorinë e kërkuar*<sup>4</sup>.

28. Pas marrjes së njohurive teorike pranë autoshkolles dhe fitimin e provës së kontrollit të njohurive *teorike* me rezultat pozitiv, pranë sektorit përkatës të DPSHTRR-së, personi i interesuar për marrjen e lejedrejtimit, *pajiset me autorizim për vazhdimin e kursit të ushtrimit të drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, nga sektori përkatës i DPSHTRR-së, nën juridiksionin e së cilës ndodhet autoshkolle.*

<sup>3</sup> Neni 311 i VKM nr. nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

<sup>4</sup> Tarifat për shërbimet që DPSHTRR ofron në sektorin e lejeve të drejtimit, në zbatim të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin rrugor. Ndër këto shërbime janë: *pajisja me leje për përgatitjen e njohurive teorike, pajisja me autorizim për vazhdimin e kursit të ushtrimit të drejtimit të mjetit, pajisja me lejedrejtimi.*

29. Pajisja me lejedrejtimi e personit që shpallet fitues në provën e verifikimit të *aftësive drejtuese dhe të sjelljes* bëhet pas pagesës së tarifës së shërbimit për lejedrejtimin, të miratuar nga ministri përgjegjës për transportet, si dhe tarifës së pajisjes me lejedrejtimi, sipas legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare, shërbime këto të cilat ofrohen nga DPSHTRR.
30. Bazuar në nenin 314 të VKM Nr. 153, datë 7.4.2000, ministria përgjegjëse për transportin rrugor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe strukturat përkatëse në drejtoritë rajonale ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e autoshkollave. Përbëjnë objekt kontrolli veçanërisht: a) dokumentacioni për licencimin dhe aftësinë profesionale të personelit; b) dokumentacioni për administrimin e aktivitetit të përcaktuar në aktet në zbatim; c) kushtet e zhvillimit të mësimit teorik, mjediset dhe pajisjet didaktike që mundësojnë zhvillimin normal të tij; ç) dokumentacioni dhe gjendja teknike e mjeteve rrugore të autoshkollës sipas normave ligjore në fuqi; d) ndjekja e seancave të zhvillimit të mësimit teorik dhe praktik; dh) respektimi i udhëzimeve, rregulloreve apo urdhrave të nxjerrë nga ministria përgjegjëse, në zbatim të Kodit Rrugor.
31. Në mbështetje të neneve 119, 120 dhe 121, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe neneve 310, 311 dhe 313, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar udhëzimin nr. 9, datë 14.4.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”.
32. Udhëzimi ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e autoshkollave si subjekte të përgatitjes së drejtuesve të mjeteve, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe kualifikimin e specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRRR), pajisjen me certifikata dhe dëshmi të aftësimin profesional, rifitimin e lejes së drejtimit nga humbja e plotë e pikëve.
33. Referuar nenit 11 të udhëzimit të MIE nr. 9/2022:

“Regjistrimi i personave të interesuar për t’u pajisur me lejedrejtimi bëhet në autoshkolla. *Para lëshimit të lejes apo autorizimit bëhet pagesa përkatëse, sipas kategorisë së lejedrejtimit. Pagesa mund të bëhet në një bankë të nivelit të dytë ose në zyrat përkatëse të DRSHTRR-së. Tarifat e pagesës duhet të jenë sipas dakordësisë ndërmjet subjekteve që organizojnë autoshkollat (grupet e interesit), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Mandatpagesa për përgatitjen e drejtuesve të mjeteve rrugore me motor depozitohet në dosjen e kandidatit për leje drejtimi. Datë regjistrimi është data e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike ose me autorizim për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes”<sup>5</sup>.*

34. Tarifat për shërbimet që DPSHTRR ofron në sektorin e lejeve të drejtimit, në zbatim të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin rrugor<sup>6</sup>. Ndër këto shërbime renditen edhe:

- pajisja me “Leje” për provën e kontrollit të njohurive teorike, si dhe,

<sup>5</sup> Trifa këto të publikuara në faqen zyrtare të DPSHTRR: <https://www.dpshtrr.al/rreth-nesh/lista-dhe-tarifat-e-sherbimeve>.

<sup>6</sup> Pikat 2 dhe 6 të nenit 311 të VKM VKM nr. nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Neni 6 i Statutit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, i miratuar nga Ministri përgjegjës për transportin rrugor.

- pajisja me autorizim për ushtrimin e drejtimit të mjetit<sup>7</sup>.

35. Për këto lloj shërbimesh bëhet fjalë edhe në nenin 11 të udhëzimit nr. 9, datë 14.4.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”, ku citohet mjaft qartë se: *“Datë regjistrimi është data e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike ose me autorizim për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes”*.
36. Nëpërmjet këtij udhëzimi, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë udhëzon subjektet që organizojnë autoshkollat (grupet e interesit), Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që të dakordësojnë ndërmjet tyre tarifave të pagesës për shërbimin e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike dhe pajisjen me autorizim për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes, duke iu lënë një hapësirë negociimi tarifave, të cilat thjesht miratohen në vijim nga ministri për këto shërbime të ofruara nga DPSHTRR.
37. Në interpretim të gabuar të nenit 11 të udhëzimit nr. 9, datë 14.4.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”, të analizuar si më sipër, është lidhur Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshkollave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ku midis palëve është dakordësuar tarifa fikse e pagesës dhe kosto referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose çertifikatës, pagesë kjo e cila i bëhet subjekteve autoshkolla kundrejt shërbimit të ofruar për përgatitjen dhe fitimin e kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose çertifikatës, ndryshe nga sa përcaktohet në nenin 11 të udhëzimit të MIE nr.9/2022, ku dakordësia ndërmjet palëve i referohet tarifave të pagesës për shërbimin e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike dhe pajisjen me autorizim për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes, shërbime këto të cilat ofrohen nga DPSHTRR.
38. Sipas nenit 1 të Akt Marrëveshjes, *“Objekt i kësaj Marrëveshje është njohja ndërmjet Palëve me tarifën e pagesës, si dhe vlerësimin e koston minimale fiskale referuese, për përmbushjen e programit të edukimit për përgatitjen për drejtues mjeti dhe pajisjen me kategoritë e lejedrejtimit: AM, A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E, DE, për përgatitjen për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj, si dhe përgatitjen për pajisjen me dëshmitë dhe çertifikatat e aftësimin profesional”*, duke përllogaritur dhe fiksuar në nenin 2 të saj, tarifën e pagesës dhe koston referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose çertifikatës.
39. Konkretisht, Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave”, e cila përfaqëson 266 autoshkolla, dhe Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë”, e cila përfaqëson 37 autoshkolla, kanë përcjellë pranë DPSHTRR<sup>8</sup> çmimet e programit për përgatitjen për drejtues mjeti. Sipas këtyre autoshkollave çmimi është bërë nga grupet e interesit në bashkëpunim me ekspertët teknik dhe ekonomik, duke mbajtur parasysh të gjithë elementet e koston dhe pikave të programit për çdo lejedrejtimi.
40. Edhe Autoshkolla “Studenti”<sup>9</sup>, ka përcjellë pranë DPSHTRR një propozim për përcaktimin e çmimit për lejen e drejtimit për kategorinë bazë B për 36 seanca teori dhe 31 seanca praktikë. Nga një krahasim i thjeshtë i llogaritjes së çmimit për lejen e drejtimit për kategorinë B, të bërë nga shoqatat nënshkruese të Akt Marrëveshjes dhe Autoshkolla “Studenti”, rezulton se kjo e fundit ka llogaritur një çmim total për një kursant për të kryer kursin e plotë në zbatim të Udhëzimit të Autoshkollave nr. 9, datë 14.04.2022, prej 46.800 lekësh (ku nuk përfshihen tarifave për shërbimet e DPSHTRR prej

<sup>7</sup><https://www.dpshttr.al/rreth-nesh/lista-dhe-tarifave-e-sherbimeve>

<sup>8</sup> Shkresa e Shoqatës Kombëtare të Autoshkollave me nr. 70 prot., datë 27.06.2022, prot. DPSHTRR nr. 16285, datë 27.06.2022, si dhe shkresa e shoqatës së autoshkollave “Siguria në rrugë” e datës 27.09.2022, prot. DPSHTRR nr. 22291, datë 28.09.2022.

<sup>9</sup> Shkresa e Autoshkollës “Studenti”, datë 25.07.2022 protokolluar pranë DPSHTRR me nr. 23582 prot., datë 18.10.2022.

rreth 10.200 lekë), ndërkohë tarifa e llogaritur nga Shoqata “Kombëtare e Autoshtokollave” dhe Shoqata e Autoshtokollave “Siguria në rrugë” për kategorinë B të leje drejtimit ka rezultuar në një vlerë mbi 80,000 lekë.

41. Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshtokollave, DPSHTRR-së dhe DPT-së, kufizon lirinë e veprimtarisë ekonomike të subjekteve autoshtokolla, të cilat në respekt të legjislacionit kanë të drejtën të përcaktojnë vetë tarifën e pagesës për përgatitjen e drejtuesve të mjeteve rrugore me motor, duke imponuar praktika të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes, sjellje e cila parashikohet si e paligjshme nga neni 4 , pika “a” e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Llogaritja e tarifave nga shoqatat e autoshtokollave në vlera shumë më të larta se tarifat aktuale të vetë autoshtokollave, nëse kjo marrëveshje hyn në fuqi, do të bëjë që autoshtokollat në mënyrë të unifikuar të aplikojnë të njëjtat tarifa, gjë e cila bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003. Përcaktimi i çmimeve nëpërmjet kësaj marrëveshje nga ana e grupeve të interesit përfaqësues të Autoshtokollave, DPSHTRR-së dhe DPT-së, kufizon konkurrencën në treg.
42. Argumentimi i DPSHTRR se: “analiza e kostos minimale fiskale në përlllogaritjen e tarifës (sipas nenit 2, të marrëveshjes), është një vlerë referuese për efekt fiskal”, nuk qëndron, pasi subjektet që zhvillojnë aktivitetin “Autoshtokollë” në RSH kanë kosto të ndryshme për realizimin e detyrueshëm të programit mësimor teorik, praktik dhe pajisjen me lejedrejtimi. Për më tepër, veprimtaria e autoshtokollave është një veprimtari e mirërregulluar me akte ligjore e nënligjore, ku vetë DPSHTRR ka një rol kyç në ofrimin e shërbimeve, mbikëqyrjen dhe mirëfunksionimin e këtij tregu, nëpërmjet kompetencave mbikëqyrëse dhe kontrolluese që i jep ligji. Shqetësimi (i arsyeshëm dhe i bazuar) se nga disa autoshtokolla po përgatiten kursantë pa njohuritë dhe aftësitë e duhura është i zgjidhur nga aktet ligjore ekzistuese, të cilat i mundësojnë DPSHTRR pajisjen ose jo me lejedrejtimi, si organi i vetëm që ka këtë kompetencë.
43. Akt Marrëveshja nr.2729 prot., datë 13.02.2023, lidhur ndërmjet grupeve të interesit përfaqësues të Autoshtokollave, DPSHTRR-së dhe DPT-së, e cila ka për objekt *de facto* dhe *de jure* caktimin e tarifës së pagesës dhe koston referuese minimale fiskale për përgatitjen dhe pajisjen me leje drejtimit, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose certifikatës, është një marrëveshje e ndaluar në vetvete për nga objekti, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 9121/2003, pasi me hyrjen në fuqi do të çojë në praktika të njëjta në çmimet/tarifat e pagesës për përgatitjen dhe fitimin e kategorisë së leje drejtimit, dëshmisë ose certifikatës, duke penguar, kufizuar dhe shtrembëruar konkurrencën në treg. Si e tillë kjo Akt Marrëveshje, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 9121/2003, është e ndaluar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, e lidhur ndërmjet palëve: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqata “Kombëtare e Autoshtokollave”,

Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vlerësohet si një akt marrëveshje në kundërshtim me nenin 4 të ligjit 9121.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- II. Monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- III. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



2023

VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
**2023**  
BULETINI ZYRTAR

